

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **POLICIA E KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214/30400-26-1946-5-1-1**

Sa i përket tenderit për: **NDËRTIMI I STACIONIT POLICOR VERI NË PRISHTINË**

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

Astraplan SHPK

Rr. Mehmet Gradica Hyr. 5/6, Bregu i Diellit

Prishtinë

10000

038 555 045

038 555 045

Florim Istrefi

astra_plan@hotmail.com

01.06.2026



**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimt të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Publikimi i tenderit ne E-PROKURIM, publikimi i tenderit është bere me datën 13.04.2026 ndërsa ofertat duhen te dorëzohen me datën 25.05.2026 para orës 14:00, si kriter i tenderit, tenderuesi i përgjegjshëm çmimi me i ulet.

Qyshe ne fillim d.m.th. ne Titullin e tenderit vërehet se AK-ja e ka filluam me qellim te caktuar këtë aktivitet duke mos e paraqitur se është RI-Tender për herën e 2të, d.m.th. ky aktivitet është anuluar edhe dy here me herët me vet fajin e AK-s, kjo është hera e trete qe është bere njoftimi për kontrate:

1. Hera e parë: 02.12.2020
2. Hera e dytë: 14.10.2022
3. Hera e tretë: 13.04.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

Po

Jo

PO, hapja është bere përmes e-prokurimit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Ne kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim me datën 19.05.2026, kemi kërkuar qe te rishqyrtohet vendimi i par i AK-s, kërkesa për ri shqyrtim është refuzuar nga AK-ja me datën 20.05.2026, edhe pse te pretendimet tona kane qenë te bazuara te mbështetura ne fakte dhe dokumente.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

- Neni 7, paragrafët 1, 2, 3, 4 dhe 6 të LPP-së
- Neni 51, paragrafët 1, 2 dhe 3 të LPP-së
- Neni 64 i LPP-së
- Neni 66 i LPP-së
- Neni 67 i LPP-së
- Neni 68 i LPP-së
- Neni 69 i LPP-së
- Neni 70 i LPP-së
- Neni 71, paragrafi 4 i LPP-së
- Neni 25.17 dhe 25.18 i Rregullores për Prokurimin Publik Nr. 001/2022, versioni i konsoliduar
- Neni 26.5 dhe 26.10 i Rregullores për Prokurimin Publik Nr. 001/2022 versioni i konsoliduar

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Neni 7, paragrafët 1, 2, 3, 4 dhe 6 të LPP-së - Barazia në trajtim, jo-diskriminimi, transparenca, ndalimi i kërkesave/kritereve që reduktojnë konkurrencën ose favorizojnë/diskriminojnë operatorë ekonomikë..

AK-ja ka bërë shkelje të rënda të këtij neni dhe paragrafëve të tij pasi që ka vendosur kushte dhe kritere të vështira për tu plotësuar dhe jo ekuivalente me projektin/aktivitetin.

4. Qyshe në fillim d.m.th. në Titullin e tenderit vërehet se AK-ja e ka filluar me qëllim të caktuar këtë aktivitet duke mos e paraqitur se është RI-Tender për herën e 2të, d.m.th. ky aktivitet është anuluar edhe dy herë me herët.

 Qarkullimi vjetor prej së paku 4,000,000.00 euro dhe kushti që minimum 60% të përmbushet nga lideri

Kërkesa e kontestuar: Në pikat 8.1 dhe 8.2 kërkohet qarkullim vjetor gjatë tre viteve të fundit, së bashku në vlerë jo më pak se 4,000,000.00 euro; në rast të grupit kërkohet që minimum 60% të plotësohet nga lideri.

Dispozitat relevante: Neni 7, Neni 51, Neni 68 dhe Neni 71.4 i LPP-së; Neni 25.17, 25.18, 26.5 dhe 26.10 i Rregullores Nr. 001/2022.

Kërkesa për qarkullim duhet të jetë e arsyetuar, e lidhur me vlerën e parashikuar të kontratës dhe e domosdoshme për të verifikuar kapacitetin financiar. Në mungesë të arsytimit pse kërkohet pikërisht pragu 4,000,000.00 euro dhe pse 60% duhet të jetë detyrues në emër të liderit, kriteri bëhet kufizues dhe mund të përjashtojë grupe operatorësh që së bashku kanë kapacitet të mjaftueshëm financiar.

Rregullorja lejon që AK të specifikojë mënyrën se si grupet përmbushin kërkesat ekonomike dhe financiare, por kjo duhet të bëhet vetëm kur është e nevojshme dhe në mënyrë proporcionale. Formulimi "minimum 60% nga lideri" pa arsyetim teknik/financiar favorizon operatorë të mëdhenj individualë dhe cenon parimin e konkurrencës së gjerë.

Kërkohet: Të hiqet qarkullimit në nivel proporcional me vlerën dhe kompleksitetin e kontratës, dhe të hiqet kushti absolut që 60% të përmbushet nga lideri, sepse është kufizim i konkurrencës.

- ✚ Kapitali financiar / qasja në kredi në vlerë 600,000.00 euro dhe kushti 60% nga lideri

Kërkesa e kontestuar: Në pikat 8.1 dhe 8.2 kërkohet kapital financiar në vlerë 600,000.00 euro ose qasje në kredi të pakushtëzuar, me emërtim të projektit dhe numrit të prokurimit; në rast të grupit kërkohet që lideri të plotësojë 60% të këtij kushti.

Dispozitat relevante: Neni 7, Neni 51, Neni 67, Neni 68 dhe Neni 71.4 i LPP-së; Neni 25.17, 25.18, 26.5 dhe 26.10 i Rregullores Nr. 001/2022.

Kërkesa për kapital financiar ose kredi, nuk kërkohet me nenin 68 të LPP-s, dhe është në kundërshtim të plotë me kërkesën për qarkullim financiar, nga se edhe po kërkohet qarkullimi edhe po kërkohet kapitali, dhe kjo i bie që është kriter i dyfishtë, ndërsa në anën tjetër Autoriteti Kontraktues është financuesi i projekti dhe jo OE që do ta nënshkruaj kontratën, kërkesa ngjan sikurse OE të jetë investitori.

Po ashtu edhe sigurimi i ekzekutimit është një garanci që projekti mos të dështoj.

Neni 68 i LPP-s mbizotëron ndaj çdo rregulloreje dhe në bazë të këtij neni, kjo kërkesë është e jashtë ligjshme dhe diskriminuese.

Kërkohet: Të largohet kjo kërkesë pasi që është kërkuar edhe qarkullimi përmes ATK-s, ose ky dokument të kërkohet të dorëzohen nga ofertuesi fitues, përpara publikimit të dhënies së kontratës.

Kontrata të ngjashme në vlerë jo më pak se 3,000,000.00 euro dhe kushti 60% nga lideri

Kërkesa e kontestuar: Në pikat 9.1 dhe 9.2 kërkohet që OE të ketë realizuar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë apo të ngjashme gjatë 3 viteve të fundit në vlerë jo më pak se 3,000,000.00 euro; në rast konsorciumi së paku 60% e projekteve kërkohet për liderin e grupit, si dhe deshmia e transaksioneve financiare.

Dispozitat e shkelura nga AK-ja: Neni 7, Neni 51, Neni 69 dhe Neni 71.4 i LPP-së; Neni 25.16, 25.17, 25.18, 26.5, 26.7 dhe 26.10 i Rregullores Nr. 001/2022.

Kriteri i tillë favorizon operatorë të mëdhenj me histori të përqendruar projektesh dhe përjashton grupe operatorësh që së bashku posedojnë përvojë të mjaftueshme dhe relevante. Kapaciteti teknik/profesional i grupit duhet të vlerësohet si tërësi.

Ne baze të LPP-s për transaksionet financiare duhet të kerkohen me sqarime gjat procesit të vlerësimit atehere kur dy OE të ndryshem ka paraqite të njejten reference ne kete aktivitet, atehere ka kuptim te kerkohen sqarimi per vleren e punimeve se sa ka kryer secili.

Po ashtu përjashtimi i kontratave për renovime është në kundërshtim të plotë me LPP-ne dhe me natyrën e projektit, pasi që vet LPP-ja njih vetem 3 lloje të kontratave. Shif njoftimin për Kontrata që vet ju si AK e keni shpallur të cilën e gjeni me poshtë klasifikimin e kontratave publike sipas LPP-s:

POLICIA E KOSOVËS

NJOFTIM PËR KONTRATË

PUNË

FURNIZIM

SHËRBIME

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Pra edhe LPP-ja edhe LIGJI Nr. 04/L –110 PËR NDËRTIM, neni 3 dhe neni 5, renovimin e konsiderojnë punë ndërtimore, me këto konstatojme se kjo dosje e tenderit është pershtatur një OE të caktuar, dhe është kufizim i konkurreces që është e ndaluar me nenin 7 të LPP-s.

Shih me poshtë kalsifikimin e puneve ndertimore sipa LIGJI Nr. 04/L –110 PËR NDËRTIM

Neni 3 i LIGJI Nr. 04/L –110 PËR NDËRTIM

Përkufizimet

1. Për qëllime të këtij ligji, termet e veçanta të përdorura në tekstin e këtij ligji, do ta kenë kuptimin si në vijim. Në raste të dykuptimësisë, definicionet në këtë ligj, do të interpretohen në përputhje me definicionet e njëjta apo të ngjashme të standardeve të aplikuara në Republikën e Kosovës, BE-se dhe ISO :

1.1. Punë ndërtimore – aktivitetet e krijimit të ndërtimeve apo objekteve ndërtimore.

1.2. Ndërtim apo objekt ndërtimor - çdo gjë që ndërtohet apo rezulton nga punët ndërtimore.

1.3. Projektim - hartimi i dokumentacionit tekniko-investig sipas Kodit të Ndërtimit dhe sipas dispozitave të këtij ligji.

1.4. Vend ndërtimi – sipërfaqe tokësore apo ujore ku zhvillohet punë ndërtimore ose ndonjë zhvillim tjetër që ka të bëjë me ndërtimin.

1.5. Rindërtimi – punë ndërtimore që ka për synim ndryshimin substancial të një ndërtimi, për shembull:

Neni 5 i I LIGJI Nr. 04/L –110 PËR NDËRTIM

Llojet e ndërtimit

1. Llojet e ndërtimit janë:

1.1. ndërtimi i ri (duke përfshirë instalimin);

1.2. rindërtimi;

1.3. riparimi – renovimi, sanimi, rehabilitimi-përmirësimi (nuk kërkon leje ndërtimi);

1.4. punët ndërtimore që kanë për synim mbrojtjen e monumenteve të palëvizshme të trashëgimisë kulturore;

1.5. rrënim;

1.6. ndërtime peizazhi, dhe

1.7. instalimi apo ngritja e ndërtimeve të përkohshme.

Kërkohet: të hiqet kushti që 60% e projekteve të jetë nga lideri dhe të pranohet përvoja e grupit të OE-ve si tërësi, po ashtu duhet të pranohen të gjitha punimet, renovimet dhe instalimet të ndryshme si të ngjashme sepse të gjitha keto aktiviteti janë edhe në këto projekt, dmth Arkitekturë, statika, hidro, elektrike dhe makineri.

Kërkesa e kontestuar: Kërkohet listë pajisjesh me specifikime të detajuara:

- **auto mikser auto pompë min. 7 ton**, të ndahet auto pompa nga mikseri, sepse kjo është bere me qëllim që gjatë vlerësimit në varësi të OE-ve me pas kinse arsye për eliminim, pra me këtë kërkesë nuk mund të bëhet vlerësim real i ofertave, sepse Mikseri me Auto pompë nuk është në gjendje të shërbejë për projektin në fjalë, ngase kapaciteti nuk i mjafton në distanca dhe lartësi siç i ka projekti i këtij aktiviteti, sepse ka mikser që e ka auto pompën e integruar, për sasi dhe distanca të vogla.
- **kamion kiper me kran min. 4.5 ton, (pesha bartese)**- nuk është e nevojshme që të kufizohet si kusht pesha bartëse, sepse afro 3 vite i keni humbur në këtë aktivitet për shkak se ka dykuptimësi se këtij kushti në aktivitetin e me paraparak për të njëjtin projekt.
- **eskavator me goma min. 20 ton,-** nuk është e nevojshme të ceket a me rrota a me vëmiza si dhe të lehet hapësirë prej deri p.sh. (prej 10 t- 25t), për shkak se minimumi i kërkuar prej 20 toneve, përbën kufizim të konkurrencës dhe është në kundërshtim me punët që do të kryhen, pasi që këto punë pa asnjë dyshim kryhen edhe me ekskavator 16t, 18t etj.
- **eskavatorë 4 ton dhe 3 ton me çekan**, kjo kërkesë duhet të hiqet sepse është larguar edhe në paramasë rrënimi i objekteve pasi që nuk ka asnjë objekt për rrënim, si dhe është një disproporcion me ekskavatorin 20 ton, kjo dihet që është vendosur për të kufizuar maksimalisht konkurrencën.
- **rul për ngjeshje maksimum 800 kg**, kjo kërkesë duhet të ndryshohet sepse është jo profesionale dhe jo proporcionale me objektin e kontratës, kjo mundet të jetë minimumi 800kg dhe jo max, sepse është shumë i vogël dhe ka shumë pak në treg, kufizim konkurrence.
- **ngjeshës hidraulik që montohet në eskavator min. 800 kg**. kjo kërkesë duhet të hiqet sepse është e pa nevojshme dhe është kufizim konkurrence.

Dispozitat relevante: Neni 7, Neni 51, Neni 67 dhe Neni 69 i LPP-së; Neni 25.17 dhe 25.18 i Rregullores Nr. 001/2022.

AK mund të kërkojë pajisje të mjaftueshme për realizimin e punëve, por kërkesat duhet të jenë funksionale dhe të lidhura me nevojën reale teknike. Lista aktuale vendos kapacitete shumë specifike, pa arsytim pse pikërisht këto pesha, tonazhe ose konfigurime janë të domosdoshme si kusht eliminues.

Kërkesat për pajisje duhet të lejojnë pajisje ekuivalente, me kapacitete të mjaftueshme për realizimin e punëve, dhe të pranojnë disponueshmërinë përmes pronësisë, qirasë, marrëveshjeve të qirasë ose kapaciteteve të subjekteve të tjera. Formulimi aktual favorizon operatorë që posedojnë pikërisht këtë konfigurim makinash dhe kufizon pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë të aftë.

Kërkohet: Të riformulohet lista e pajisjeve në mënyrë funksionale, duke specifikuar kapacitetin e nevojshëm teknik dhe duke pranuar pajisje ekuivalente, si dhe të merren parasysh të cekurat tona më lart.

Kërkesat diskriminuese si më sipër, të marra së bashku, nuk përfaqësojnë vetëm verifikim normal të aftësisë së OE-së për ekzekutimin e kontratës. Ato krijojnë një konfigurim të ngushtë financiar, teknik, organizativ dhe dokumentar, i cili ul numrin e operatorëve që mund të marrin pjesë dhe rrit rrezikun që tenderi të jetë i përshtatur për një numër të kufizuar operatorësh (1 operator). Kjo bie ndesh me parimin themelor të LPP-së për konkurrencë sa më të gjerë, barazi në trajtim, jo-diskriminim dhe proporcionalitet.

Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë kapacitete reale dhe të domosdoshme për realizimin e punëve, por këto kërkesa duhet të formulohen në mënyrë të hapur, funksionale dhe të arsyetuar, duke pranuar ekuivalentët dhe duke mos e kufizuar pjesëmarrjen e OE-ve që posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme.

Po ashtu duke e ditur se ky aktivitet i prokurimit është shpallur për herën e 3 kësaj radhe, ne vend se të lehtësoj pjesëmarrjen e OE dhe të jetë konkurrenca sa më e gjere, ju si AK vetëm sa e keni vështirësuar pjesëmarrjen dhe e keni kufizuar në maksimum.

Duke u bazuar në faktet dhe dispozitat e mësipërme, kërkojmë nga OSHP që të merr:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar** ankesa e Operatorit Ekonomik ASTRAPLAN SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit: NDËRTIMI I STACIONIT POLICOR VERI NË PRISHTINË, me nr. Prokurimit 214/30400-26-1946-5-1-1.
- II. Te detyroj** Autoritetin Kontraktues Policia e Kosovës që të korrigjoj kriteret diskriminuese në mënyrë që të kenë mundësi pjesëmarrje me të gjerë të OEve, pasi që OSHP-ja kanë përvojë në mos respektimin e vendimeve të tyre nga ZPP në Policinë e Kosovës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kërkesat e kontestuara i shkaktojnë ose rrezikojnë t'i shkaktojnë parashtruesit dëm material dhe procedural, sepse e pengojnë pjesëmarrjen e lirë dhe të barabartë në procedurë, e rrisin koston e përgatitjes së ofertës, krijojnë rrezik real të eliminimit për arsye formale dhe të paarsyetuara, si dhe e kufizojnë mundësinë për të konkurruar për kontratën publike.

Dëmi nuk konsiston vetëm në humbjen eventuale të kontratës, por edhe në humbjen e mundësisë për konkurrim të drejtë, shpenzimet për sigurimin e dokumenteve të panevojshme, angazhimin e parakohshëm të stafit/punëtorëve dhe pamundësinë për të përdorur kapacitetet e grupit, nënkontraktorëve ose subjekteve të tjera në mënyrë të lejuar nga LPP-ja.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*